



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 28.4.2021

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 28.4.2021, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore të datës 1.4.2021, bazuar në nenin F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 45, të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të shqyrtimit të çështjes objekt ankimi, trupi gjykues vendosi që, në kuadër të çeljes së hetimit gjyqësor, të kërkojë akte shtesë nga Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Vlorë dhe Durrës, nga *** Bank, si dhe nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Këto akte janë përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar të premtën, datë ***.4.2021, me nr. ***/*** prot., dhe të martën, datë ***.4.2021, me nr. ***/*** dhe ***/***.

Nga ana e Kolegjit, me praktikat e lartpërmendura, na janë përcjellë aktet si më poshtë:

A. Akte të sjella nga Gjykata e Lartë (6 dosje gjyqësore - gjithsej 1411 fletë), që i përkasin:

1. Dosjes gjyqësore me palë paditëse *** ***,
2. Dosjes gjyqësore me palë paditëse *** ***, dhe *** ***,
3. Dosjes gjyqësore me palë paditëse “****” sh.p.k.;
4. Dosjes gjyqësore me palë paditëse *** ***,
5. Dosjes gjyqësore me palë paditëse *** ***,
6. Dosjes gjyqësore me palë paditëse ***.

B. Akte të sjella nga Gjykata Administrative e Apelit (gjithsej 86 fletë), që i përkasin:

1. Dosjes gjyqësore me palë paditëse *** Bank sh.p.k.;

2. Dosjes gjyqësore me palë paditëse “**** *** ****” sh.p.k.;
3. Të dhënave për shortet e hedhura pranë kësaj gjykate për çështjet me palë ndërgjyqëse kompaninë “**** ****” sh.p.k.;
4. Të dhënave për shortet e hedhura pranë kësaj gjykate për çështjet me palë ndërgjyqëse kompaninë “**** ****” sh.a.

C. Akte të sjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (gjithsej 545 fletë), që i përkasin:

1. Dosjes gjyqësore me palë paditëse “**** & *** ****”;
2. Dosjes gjyqësore me palë paditëse “**** ****” sh.p.k.;
3. Dosjes gjyqësore me palë paditëse Federata Shqiptare e Judos.

D. Akte të sjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë (gjithsej 166 fletë), që i përkasin:

1. Dosjes gjyqësore me palë paditëse **** ****.

E. Akte të sjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës (gjithsej 134 fletë), që i përkasin:

1. Dosjes gjyqësore me palë paditëse shoqëria “**** ****” sh.p.k. dhe palë e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan etj.

F. Aktet e sjella nga ** **** Bank (gjithsej 4 fletë) dhe aktet e sjella nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (gjithsej 30 fletë).**

I. Komisioneri Publik, në vlerësim të përmbajtjes së akteve, duke i analizuar ato në raport me secilin shkak ankimi, konstaton se:

A. Për aktet e përcjella nga Gjykata e Lartë

1. *Dosja gjyqësore me palë paditëse **** **** vs Drejtoria e Rrugëve me objekt (referuar padisë) “Pagim i dëmshpërblimit të truallit të shpronësuar për interes publik me VKM-në nr. 129, datë 12.2.2012...”. Referuar përmbajtës së padisë datë ****.7.2012, paditësja thekson se: “... për procedurat e shpronësimit dhe kalimin e vlerave të dëmshpërblimit unë nuk jam njoftuar zyrtarisht në asnjë rast sipas ligjit...”. Më tej, paditësja gjatë ecurisë së procesit gjyqësor, pasi ka thirrur palë të tjera në gjykim, ka saktësuar edhe objektin e padisë.*

➤ *Sa më sipër*, nuk konstatojmë të dhëna shtesë në ndihmë të sa kemi parashtruar në shkaqet e ankimit për këtë denoncim. Kjo çështje gjyqësore rezulton në pritje për t’u gjykuar në Gjykatën e Lartë.

2. *Çështja gjyqësore “****” sh.p.k. vs Dr. Rajonale Tatimore Berat, Dr. Përgjithshme e Tatimeve me objekt: “shfuqizim akti...”. Kjo çështje lidhet me shkaqet e ankimit, konfliktin e interesit apo ndërmarrje e veprimeve me vonesë nga subjekti i rivlerësimit, për të mënjnuar çdo dukje të konfliktit të interesit.*

Sipas shortit manual të datës ***.4.2016, rezulton se çështja është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në datën ***.11.2014.

Trupi gjykues është: ***. *** - relatore, K. Selita dhe ***. *** - anëtarë, të cilët kanë marrë vendimin nr. ***/2016, për prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Berat dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është ushtruar rekurs.

➤ **Sa më sipër**, nga aktet e përcjella pranë IKP-së, konstatojmë se nuk është pjesë vendimi nr. ***/*** prot., datë ***.8.2012, i DA Tatimore pranë Dr. Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, për të konstatuar nëse personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja, e ka nënshkruar.

3. Çështja gjyqësore me palë paditëse * *** dhe *** *** vs KM, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkia Berat me objekt: “ndryshim pjesërisht i VKM-së nr. 519/2015... Detyrim për shpërblimin e drejtë...”.** Kjo çështje lidhet me denoncimin e shtetasit ***. ***, administruar dhe përcjellë nga KPA-ja. Mbi pretendimet e këtij denoncuesi, subjekti ka mbajtur qëndrim në seancën gjyqësore të datës ***.3.2021 (si një nga 12 denoncimet).

➤ Nga aktet e përcjella pranë IKP-së rezulton të jetë administruar vetëm padia dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si dhe ankimi i këtij vendimi nga denoncuesi.

4. Çështja gjyqësore me palë paditëse * *** vs Kantieri i Ndërtimit të Anijeve *****, me objekt: “Detyrim i të paditurit të dëmshpërblejë paditësin me pagën e 12 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës...”. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues dhe se kjo çështje lidhet me denoncimin e Kantierit të Ndërtimit të Anijeve ***, Vlorë, pjesë e shkaqeve tona të ankimit.

➤ Vërejmë se në çështjen e mësipërme, në referencë të dy rasteve të tjera, të parashtruara në shkaqet e ankimit (paditës ***. *** dhe ***. ***), ankim kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka disponuar me rrëzimin e padisë, ka paraqitur pala paditëse. Ndërkohë në të dyja rastet, pjesë e ankimit të Komisionerit Publik, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë zgjidhje të ndryshme, ankues ka qenë pala e paditur dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ka disponuar tej kufijve të kërkimeve në ankimin e palës.

5. Çështja gjyqësore me palë paditëse * *** vs Kantieri i Ndërtimit të Anijeve *****, me objekt: “Detyrim i të paditurit të dëmshpërblejë për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës...”. Kjo çështje lidhet me denoncimin e Kantierit të Ndërtimit të Anijeve ***, Vlorë, pjesë e shkaqeve të ankimit.

➤ **Sa më sipër**, nga aktet e përcjella pranë IKP-së nuk konstatojmë të dhëna shtesë në ndihmë të sa kemi parashtruar në shkaqet e ankimit për këtë denoncim nga Kantieri i Ndërtimit të Anijeve.

6. Çështja gjyqësore me palë paditëse *. ***, ***, ***, ***, me objekt: “Shfuqizimin/konstatimin e pavlefshmërisë së pjesshme absolute të VKM-së së datës 30.3.2016, për sa i përket pjesës që cenon pronën e paluajtshme ... të familjes ***”.** Kjo çështje lidhet me denoncimin e bërë nga një grup gjyqtarësh, por që nuk është bërë pjesë e analizës së shkaqeve të ankimit.

➤ Kjo çështje lidhet me denoncimin e bërë nga një grup gjyqtarësh, e cila në funksion të shkaqeve të ankimit, është referuar si mangësi e hetimit administrativ nga ana e Komisionit.

B. Për aktet e sjella nga Gjykata Administrative e Apelit, të cilat lidhen me shkaqet e ankimit, konfliktin e interesit apo ndërmarrje e veprimeve me vonesë nga subjekti i rivlerësimit, për të mënjeluar çdo dukje të këtij konflikti

1. Çështja gjyqësore “* Bank” sh.a. vs Dr. Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Komisioni i Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore pranë MF**

Sipas RIV (regjistri i veprimeve), rezulton se çështja është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në datën ***.4.2018 (***-***-***-2018).

Shorti është hedhur në datën ***.6.2018, nga ku ka rezultuar trupa me gjyqtarë: ***. *** - relatore, ***. *** (***) dhe K. Selita - anëtarë.

Në datën ***.2.2019, me kërkesën nr. *** prot., subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, pasi vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore pranë MF, objekt shqyrtimi gjyqësor, është nënshkruar edhe nga bashkëshortja e subjektit.

Në datën ***.3.2019, është ndryshuar trupa, bazuar në vendimin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, me nr. ***/*** prot., datë ***.3.2019, për pranimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi.

➤ *Sa më sipër*, nga aktet e përcjella pranë IKP-së rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, ka marrë dijëni mbi objektin konflikt gjyqësor prej qershorit 2018 dhe pas 7 muajsh, shkurt 2019, ka paraqitur dorëheqjen nga çështja, miratuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Çështja gjyqësore “* ***...”, degë e shoqërisë së huaj, vs Dr. Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Komisioni i Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore pranë MF**

Sipas RIV (regjistri i veprimeve), rezulton se çështja është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në datën ***.11.2018 (***-***-***-2018).

Shorti është hedhur në datën ***.11.2018, nga ku ka rezultuar trupa me gjyqtarë: K. Selita - relator, ***. *** (***) dhe ***. *** - anëtarë.

Në datën ***.6.2019, me kërkesën nr. *** prot., subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, pasi vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore pranë MF, objekt shqyrtimi gjyqësor, është nënshkruar edhe nga bashkëshortja e subjektit.

Në datën ***.7.2019 është ndryshuar trupa, bazuar në vendimin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë me nr. *** prot., datë ***.6.2019, për pranimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi.

➤ *Sa më sipër*, nga aktet e përcjella pranë IKP-së rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të trupit gjykues, ka marrë dijëni mbi objektin konflikt gjyqësor prej nëntorit

2018 dhe pas 6 muajsh, qershor 2019, ka paraqitur dorëheqjen nga çështja, miratuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

3. Shortet e hedhura pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet me palë ndërgjyqëse kompaninë “* **” sh.p.k. dhe “*** **” sh.a.** Këto të dhëna lidhen me shkakun e ankimit për mos hetimin nga ana e Komisionit të të gjitha indicieve të dala nga denoncimi i bërë nga një grup gjyqtarësh.

Nga të dhënat e administruara në formë tabelare rezulton se për çështjet e gjykuara me palë procedurale apo në cilësinë e personit të tretë:

- Për shoqërinë “*** **” sh.p.k., nga 50 çështje gjyqësore dhe 5 kërkesa civile (kërkim për përjashtim gjyqtari), subjekti i rivlerësimit rezulton në cilësinë e relatorit në 2 çështje, njëra me objekt: “*Shfuqizim i pjesshëm i njoftim vlerësimit për taksat dhe tarifatat vendore...*” dhe tjetra me objekt: “*...detyrim për shpronësim të drejtë nga procedurat e shpronësimit publik*”. Gjithashtu, në 3 çështje, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues me objekt gjykimi të njëjtë, si më sipër dhe shfuqizim akti për ndërprerje punimesh.
- Për shoqërinë “*** **” sh.a. rezulton se subjekti ka gjykuar dy çështje, një në vitin 2014, në cilësinë e relatorit me objekt: “*...shfuqizim vendimi të Drejtorisë së Inspektimit të Meteorologjisë Tiranë...*” dhe një në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues.

C. Për aktet e sjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, të cilat lidhen me shkaqet e ankimit, konfliktin e interesit apo ndërmarrje e veprimeve me vonesë nga subjekti i rivlerësimit për të mënjeluar çdo dukje të këtij konflikti

1. Dosja gjyqësore me palë paditëse shoqëria “*&*** **” sh.p.k. dhe palë e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë...**

Sipas shortit manual, të datës ***.11.2014, rezulton se trupi gjykues i përbërë nga: K. Selita - relator, ***. *** dhe ***. *** - anëtarë, kanë marrë vendimin nr. ***, datë ***.12.2014, për palët dhe objekt gjykimi si më sipër, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

➤ **Sa më sipër**, nga aktet e përcjella pranë IKP-së nuk konstatojmë që personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, të ketë nënshkruar ndonjë akt administrativ, i cili më pas të jetë bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit.

2. Dosja gjyqësore me palë paditëse shoqëria “* **” sh.p.k. dhe palë e paditur Drejtoria e Apelit Tiranë ...**

Sipas RIV (regjistri i veprimeve), rezulton se çështja është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në datën ***.7.2016.

Shorti është hedhur në datën ***.7.2016, nga ku ka rezultuar trupa me gjyqtarët: K. Selita - relator, ***. *** dhe ***. *** - anëtarë.

Trupi gjykues, ka marrë vendimin nr. ***, datë ***.3.2017, për palët dhe objekt gjykimi si më sipër, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

➤ *Sa më sipër*, nga aktet e përcjella pranë IKP-së nuk konstatohet që personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, të ketë nënshkruar ndonjë akt administrativ, i cili më pas të jetë bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit.

3. Dosja gjyqësore me palë paditëse Federata Shqiptare e Judos dhe palë e paditur Drejtoria e Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në Dr. Rajonale e Tatimeve Tiranë etj.

Sipas RIV (regjistri i veprimeve), rezulton se çështja është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në datën ***.5.2015.

Shorti është hedhur në datën ***.5.2019, nga ku ka rezultuar se subjekti, K. Selita, është në cilësinë e anëtarit.

Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin nr. ***, datë ***.4.2017, për palët dhe objekt gjykimi si më sipër, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

➤ *Sa më sipër*, nga aktet e përcjella pranë IKP-së nuk konstatohet që personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, të ketë nënshkruar ndonjë akt administrativ, i cili më pas të jetë bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit.

D. Për akte të sjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, çështje që lidhet me denoncimin e Kantierit të Ndërtimit të Anijeve *, Vlorë, pjesë e shkaqeve të ankimit**

➤ Nuk konstatohet të dhëna shtesë në ndihmë të sa kemi parashtruar në shkaqet e ankimit për këtë denoncim nga Kantieri i Ndërtimit të Anijeve.

E. Për aktet e sjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, të cilat lidhen me shkaqet e ankimit, konfliktin e interesit apo ndërmarrje e veprimeve me vonesë nga subjekti i rivlerësimit për të mënjeluar çdo dukje të konfliktit të interesit

Sipas RIV (regjistri i veprimeve), rezulton se çështja është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në datën ***.4.2015.

Shorti është hedhur në datën ***.4.2015, nga ku ka rezultuar se subjekti, K. Selita, është në cilësinë e anëtarit.

Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin nr. ***, datë ***.3.2017, për palët dhe objekt gjykimi si më sipër, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

➤ *Sa më sipër*, nga aktet e përcjella pranë IKP-së nuk konstatohet që personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, të ketë nënshkruar ndonjë akt administrativ, i cili më pas të jetë bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit.

F. Për aktet e sjella nga * *** Bank dhe aktet e sjella nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës**

Konstatojmë se, referuar shkresës me nr. ***/***/*** prot., datë ***.4.2021, të *** *** Bank, lidhur me lëvizjet në llogari bankare të personit juridik “*** *** ***” dhe individit *** ***, ndryshe nga sa kërkon të provohet dhe të pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se nuk identifikohet asnjë transaksion bankar në këto llogari, të kryera nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, znj. ***. ***.

Ndërsa, për sa i përket praktikës së sjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, lidhur me përlllogaritjen e vlerës së tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e banesës dykatëshe, në ish-pronësi të familjes së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, kjo Agjenci parashtron se, duke qenë se banesa është ndërtuar sipas lejes së ndërtimit dhe nuk ka pasur një kontratë paraardhëse blerjeje, si dhe është regjistruar në vitin 2006 (pas datës 1 janar 2003), vlera e blerjes, në shumën 7.241.400 lekë, është llogaritur referuar pikës 6.3 të Udhëzimit të përbashkët nr. 9, datë 26.2.2008, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Shtojcës 1 të tij, duke shumëzuar sipërfaqen e ndërtimit 268.2 m² me koston minimale fiskale për vitin 2004, në shumën 27.000 lekë, për qytetin e Tiranës, bazuar në marrëveshjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 29.3.2006. Kësaj vlere i është shtuar edhe çmimi i blerjes së tokës sipas kontratës së blerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2002, në shumën 600.000 lekë, duke rezultuar në një vlerë totale prej 7.841.400 lekë.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA